

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kina shton kontrollin, rregulla e reja kufizojnë udhëtimet dhe daljet nga vendi - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/kina-shtron-kontrollin-rregulla-te-reja-gjitheperfshirese-kufizojne-udhetimet-dhe-daljet-nga-vendi/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHÀ


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:01:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:00:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	02b0c904f2d1047e49ee3d8a5f7092a8dc3c085799e992d9a05f722b8f57b776
TEKSTI	61cfc87bc63752b8616d857c185561046115ff948e7da6118c7d56487e17fb94
PAMJA	924f63b2c309063f1ff4821e0572686566cf4b60f1d053c5b937f0bae151aa77

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fc34f7211da6dec03ca10d1b7710ae20af23f9f8116d50431c861eb7d8c4a700
E MËPARSHMJA	4dadccfa1120549455b23a651ecd7e031819e0c2f6941166fa2d085244a4a920
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fc34f7211da6dec03ca10d1b7710ae20af23f9f8116d50431c861eb7d8c4a700>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Erion Veliaj Donald Trump Bekim Sejdiu BE

BOTA

Kina shton kontrollin, rregulla e reja kufizojnë udhëtimet dhe daljet nga vendi

15 Shtator 2026 | 09:00

Kina ka vendosur një sërë rregullash të reja gjithëpërfshirëse që kufizojnë udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, një veprim që vëzhguesit thonë se do t'i japë qeverisë edhe më shumë kontroll mbi qytetarët e saj.

Qytetarëve që konsiderohen se kanë "dëmtuar" sigurinë ose interesat kombëtare të Kinës ndërsa ndodhen jashtë shtetit mund t'u ndalohet gjithashtu të largohen nga Kina deri në tre vjet.

Por ligji thotë gjithashtu se do të zbatohet për këdo që konsiderohet kërcënim për sigurinë industriale ose teknologjike të vendit.

Kina po i mban nën vëzhgim të ngushtë sektorët si gjysmëpërçuesit dhe inteligjenca artificiale, ndërsa gara midis Pekinit dhe Uashingtonit për dominimin në teknologji po nxehet. Sipas raportimeve, kufizime udhëtimi u vendosën më parë për disa drejtues nga këto industri.

Në mars, bashkëthemeluesit e Manus, një kompani e inteligjencës artificiale që ishte blerë nga Meta, thuhet se u ndaluan të largoheshin nga Kina.

Sipas rregullave të reja, zyrtarët kufitarë tani duhet t'i këshillojnë shtetasit kinezë të mos udhëtojnë në vende dhe rajone të konsideruara "me rrezik të lartë".

Por edhe para se të shpalleshin rregullat, disa njerëzve u ishte ndaluar të shkonin në vende të caktuara. Nëpunësit civilë ishin ndër grupet e para që iu nënshtruan këtyre kontrolleve, të cilat më vonë u zgjeruan për të përfshirë punonjësit e ndërmarrjeve shtetërore dhe qytetarët e zakonshëm.

Kina ishte kryesisht e izoluar nga bota nën regjimin dekadash të Maos dhe udhëtimet ndërkombëtare u bënë pjesë e jetës për kinezët vetëm në vitet 1990, pasi Kina iu nënshtrua një sërë reformash dhe hapjeje.

Kufizimet e ndryshme të udhëtimit të sotme, "rikthejnë kujtimet e asaj epoke të dhimbshme".

Piyao, një platformë qeveritare kineze që "hedh poshtë thashethemet", publikoi një deklaratë javën e kaluar duke thënë se rregullat e reja "nuk kufizojnë udhëtimin e qytetarëve të zakonshëm, por shërbejnë si një masë parandaluese kundër destinacioneve me rrezik të lartë dhe individëve me modele të pazakonta udhëtimi".

Rregulloret u nxorën për të adresuar "probleme" të tilla si njerëzit që mashtrohen për t'u

LAJMI I FUNDIT

09:07 Zbulohet "mega-Toka" misterioze, planeti 23.5 herë më masiv se Toka që sfidon shkencëtarët

08:54 Incident në Detin Baltik, fregata ruse lëshon flakadanë drejt helikopterit danez

08:49 Çmimet Emmy 2026, lista e plotë e fituesve

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

08:42 BE-ja zgjat afatin e sanksioneve ndaj Rusisë

08:35 Tensionet tregtare me Kanadanë, hyjnë në fuqi tarifat 50% të SHBA-së për 110 produkte kanadeze

08:34 Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa dhe dronë

TESTIM

larguar nga vendi ose për t'u përfshirë në lojëra të paligjshme fati dhe aktivitete mashtruese jashtë vendit, thuhet në deklaratë.

Sipas informacionit të disponueshëm publikisht, qytetarët kinezë aktualisht nuk mund të kontrollojnë vetë nëse i nënshtrohen kontrolleve të daljes.

Nëse nuk lëshohet njoftim zyrtar me shkrim ose me gojë, njerëzit në përgjithësi zbulojnë se u është ndaluar të largohen vetëm kur aplikojnë për dokumente ose kur përpiqen të largohen.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kinës dhe autoritetet e imigracionit nuk iu përgjigjën pyetjeve nga BBC Chinese.

Autoritetet kineze kanë rritur në mënyrë drastike ndalimet e daljes për qytetarët e tyre vitet e fundit, sipas të dhënave të ofruara për BBC nga grupi i të drejtave të njeriut Safeguard Defenders.

Ndërsa baza e të dhënave e Gjykatës Supreme të Kinës tregoi vetëm 89 të dhëna që përmendnin ndalimet e daljes në vitin 2016, një shifër që u rrit në 188,760 vitin e kaluar.

Përqindja e vendimeve civile që kishin të bënin me ndalimet e daljes u rrit gjithashtu më shumë se 30 herë midis viteve 2019 dhe 2025, nga rreth 0.23% në 7.3%. Vëllimi aktual i çështjeve të tilla besohet të jetë edhe më i lartë, për shkak të një numri në rritje të vendimeve të pezulluara.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Zbulohet “mega-Toka” misterioze, planeti 23.5 herë më masiv se Toka që sfidon shkencëtarët

Astronomët kanë zbuluar një ekzoplanet jashtëzakonisht të pazakontë, Gj 523b, me një masë rreth 23,5 herë më të madhe se Toka, por që, ndryshe nga...

09:07 | 15/09/2026

BOTA

Incident në Detin Baltik, fregata ruse lëshon flakadanë drejt helikopterit danez

Një fregatë ruse lëshoi dy flakadanë drejt një helikopteri ushtarak danez në ujërat ndërkombëtare pranë brigjeve të Danimarkës të hënën, duke e rrezikuar nga afër...

08:54 | 15/09/2026

BOTA | KULTURË

Çmimet Emmy 2026, lista e plotë e fituesve

Mariska Hargitay prezantoi ceremoninë e 78-të të Çmimeve Emmy, e cila u zhvillua drejtpërdrejt nga Teatri Peacock në Los Angeles, të hënën, më 14 shtator....

08:49 | 15/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.